



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 3/5 prot.

Tiranë, më 20.1.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Anita Mici
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 6.1.2021, është njoftuar vendimi nr. 287, datë 4.8.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim znj. Anita Mici, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, është gjyqtare prej vitit 2005 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Durrës. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

**2.** Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin znj. Anita Mici ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e

të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Anita Mici”, ka referuar:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie;
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.11.2017<sup>1</sup>, me konstatimin: *për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*. Raporti i DSIK-së është hartuar pa administruar informacionin e institucionit të verifikimit, Shërbimi Informativ Shtetëror.

2.2.1 Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2018, drejtuar DSIK-së, ka kërkuar rishikimin e raportit nr. \*\*\*/2017, që i përket subjektit të rivlerësimit Anita \*\*\* Mici (\*\*\*), me informacionin shtesë të dërguar nga SHISH-i.

2.2.2 DSIK, pas kërkesës së Komisionit, ka dërguar raportin e rishikuar me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2018, me konstatimin: *për papërshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës*.<sup>2</sup>

2.2.3 Për sa më sipër, nga DSIK-ja, në mënyrë të përmbledhur, është konkluduar se bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016, të dhënat që disponohen për subjektin e rivlerësimit vlerësohen në papajtueshmëri të plotë me detyrën e saj.

2.2.4 Në përfundim, ky institucion ka konkluduar se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim me kontaktet e papërshtatshme, cenon pastërtinë e figurës, në referencë të kriterit të përcaktuar në germën “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, duke u ndryshuar nga Grupi i Punës pranë DSIK-së konstatimi fillestar në lidhje me gjetjet për vlerësimin e këtij subjekti.

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

<sup>1</sup> Deklasifikuar me vendimin nr. \*\*\* datë \*\*\*.4.2020, të KDZH-së.

<sup>2</sup> Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.12.2018, të KDZH-së, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016.

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se: (i) nuk u provuan dyshimet e DSIK-së; (ii) u provua se subjekti kishte deklaruar në funksion të raportit të DSIK-së marrëdhënien me të afërmit e saj/djemtë e tezes, të dhënat e tyre personale, lidhjen e gjakut, si edhe veprën penale për të cilën janë akuzuar e dënuar dhe që, për pasojë, ndaj saj nuk mund të zbatohet ndonjë masë penalizuese brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, çmohet dërgimi për inspektim i njëjës prej dosjeve të gjykuara nga subjekti me cilësinë e anëtares së trupës gjyqësore, duke arsyetuar në pikën III/2.a të vendimit se kjo dosje është e pamjaftueshme<sup>3</sup> për të arritur në vlerësimin e saj, sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në referencë të nenit 59/1, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Durrës;*
- *Transferimin e çështjes gjyqësore, regjistruar me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2016, përfunduar me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.*

## II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

---

<sup>3</sup> Neni E, pika 1 e aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre, të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; neni 59, i ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, ku në paragrafin 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqësive të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 e Komisionit të Venecias).

**6.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**7.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**8.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**9.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 287/2020, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**10.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: *(i)* deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të pasurisë; *(ii)* rezultatet e hetimit të Komisionit dhe barrën e provës mbi vlerësimin profesional, lidhur me: *(a)* të dhënat e verifikuara referuar edhe nga raporti për vlerësimin e aftësive profesionale, hartuar nga organi ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, KLGJ; *(b)* të dhënat e verifikuara referuar edhe informacionit të Ministrisë së Drejtësisë; *(c)* të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit mbi vendimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës; *(d)* të dhënat e rezultuara nga denoncimet e publikut kundrejt subjektit të rivlerësimit depozituar pranë Komisionit gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; si dhe *(e)* rezultatet e hetimit administrativ, si një vlerësim tërësor edhe i gjetjeve të organeve ndihmëse në procesin e rivlerësimit.

**11.** Në referencë të përmbajtjes të pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 59 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

**12.** Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

## II.A Analiza e shkaqeve të ankimit

### *Për vlerësimin e pasurisë*

**13.** Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**14.** Komisioneri Publik, në referencë të kriterëve të përcaktuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, që kanë gjetur interpretim nga jurisprudenca e Kolegjit, në rastin konkret, kërkon shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve: *(i)* vlerësimin e mundësive financiare të subjektit për të realizuar pagesat për kontratën e porosisë së apartamentit, me sip. 104.33 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë; *(ii)* vlerësimin e mundësive financiare për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për vitet 2005, 2007, 2009-2014; *(iii)* vlerësimin e mundësive financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme blerjen e një automjeti.

**15. A.1 Pasuria apartament banimi, me sip. totale 104.33 m<sup>2</sup> (në vijim referuar apartament 104 m<sup>2</sup>), porositur sipas kontratë sipërmarrjeje datë \*\*\*.3.2006, me adresë në Tiranë, në vlerën 75.000 euro**

15.1 Në Deklaratën “Vetting” (në vijim D-Vett.), personi i lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: [...] Kontratë sipërmarrjeje, datë \*\*\*.3.2006, për blerje apartament banimi me sip. totale 104.33 m<sup>2</sup> me adresë në Tiranë, në vlerën 75.000 euro, apartamenti i paregjistruar. *Burimi i krijimit:* (i) Kredi bankare në \*\*\* Bank në shumën 45.000 euro, (ii) kursime familjare dhe (iii) ndihmë nga prindërit. *Vlera 75.000 euro* [...]. *Pjesë takuese* - nuk deklarohet.

15.1.1 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “Të Dhëna Konfidenciale”, personi i lidhur z.\*\*\*.\*\*\*, lidhur me burimin e blerjes së apartamentit, ka deklaruar: [...] *Për blerjen e apartamentit në vlerën 75.000 euro sqaroj se është marrë kredi në \*\*\* Bank, në shumën 45.000 euro, 5.000 euro nga kursimet familjare dhe pjesa tjetër, prej 25.000 euro, ndihmë nga babai im, si rezultat i ndarjes nga familja...si burim babai ka përdorur të ardhura nga kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë \*\*\*.11.1995, në shumën 100.000 USD (pronë e trashëguar dhe kthyer nga K. K. Pronave sipas vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.1995). Kontrata e shitjes nr.\*\*\*, datë \*\*\*.8.2000, në shumën 4.500.000 lekë (pronë e trashëguar dhe kthyer nga K.K. Pronave sipas vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.1995)[...].*

15.2 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit, znj. Mici, ka deklaruar: [...]Prenotuar apartament 104.33 m<sup>2</sup> në Tiranë, sipas kontratës datë \*\*\*.3.2006, me vlerë totale 75.000 euro, ku të paguara *cash*, vlera 25.000 euro ose 3.000.000 lekë. Pjesa takuese 50%[...].

15.2.1 Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar [...] *(i) Dhënë nga babai si rezultat i ndarjes familjare, për blerjen e apartamentit (shtëpi më vete), nga shitja e pronave të tij të trashëguara, shuma 3.000.000 lekë, pjesa takuese 50%. (ii) Kredi e marrë në Bankën*

\*\*\*.\*\*\*, për blerjen e apartamentit në Tiranë, në shumën 45.000 euro, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2006 [...].

15.3 Në aktet e dosjes së Komisionit, ndër të tjera, janë administruar: (i) kontrata e sipërmarrjes, datë \*\*\*.3.2006, me palë sipërmarrëse investitore shtetasen \*\*\*.\*\*\* (\*\*\*) dhe palë porositëse \*\*\*.\*\*\*, me objekt apartamentin nr. \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, me sip. totale 104.33 m<sup>2</sup>. Nga përmbajtja e këtij akti rezulton se vlera totale e këtij apartamenti është 75.000 euro. Porositësi, z. Mici, i ka dorëzuar palës sipërmarrëse 25.000 euro sipas mandat-arkëtimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2006. Pjesa tjetër e shumës së papaguar, prej 50.000 euro, do të paguhet nga porositësi me marrjen e kredisë nga \*\*\* Bank. Sipas përmbajtjes së kontratës, apartamenti i përshkruar më sipër, i është dorëzuar porositësit nga investitorja; (ii) shkresa e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2019, e cila konfirmon pasuritë e paluajtshme në emër të personit të lidhur z. \*\*\*.\*\*\* dhe personit tjetër të lidhur z. \*\*\*.\*\*\*; (iii) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.1995, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të ish-Pronarëve të Bashkisë Vlorë, me anë të të cilit njihen si ish-pronarë të disa pasurive të paluajtshme të \*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, trashëgimtarët e tij, ku tri pasuri kthehen në natyrë dhe për një pasuri u njihet kompensimi; (iv) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.1995, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të ish-Pronarëve të Bashkisë Vlorë, me anë të të cilit njihet si ish-pronar z. \*\*\*.\*\*\*; (v) Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2006, i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili ndryshon vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.1995, ku pasuria e njohur për kompensim u kthehet fizikisht trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, z. \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.

15.4 Komisioni, në vijim të hetimit mbi pasurinë e porositur, apartament me sip. 104 m<sup>2</sup>, ka kryer analizën financiare mbi mundësitë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të investuar me të ardhura të ligjshme në fitimin e të drejtave mbi këtë pasuri. Referuar rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke konstatuar se: [...] *duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 116.198 lekë për të investuar në këtë pasuri, si edhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare*<sup>4</sup>[...].

15.5 Komisioni, pavarësisht se i ka kaluar subjektit barrën e provës vetëm lidhur me balancën negative të rezultuar për këtë vit kalendarik, ka arsyetuar lidhur edhe me ligjshmërinë e shumës 3.000.000 lekë, deklaruar si dhurim nga babai i bashkëshortit, që sipas arsyetimit të Komisionit rezulton e provuar.<sup>5</sup>

15.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *pavarësisht se në këtë vit vjeherri i saj ka dhënë shumën 3.000.000 lekë, përsëri duhet të përlllogaritet edhe ndihma financiare e dhënë prej tij në mënyrë të vazhdueshme në shumën 300.000 lekë, pasi, sipas subjektit, kjo ndihmë edhe në këtë vit nuk ka munguar* [...] <sup>6</sup>

15.7 Komisioni, pas administrimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se: [...] *Fakti që subjekti ka deklaruar në kohë reale shumën 3.000.000 lekë dhënë nga vjeherri i saj, trupi gjykues ka konsideruar se në këtë shumë është e përfshirë edhe ndihma e pretenduar në mënyrë konsistente po nga vjeherri, në shumën 300.000 lekë. Gjithsesi, në këtë*

<sup>4</sup> Referohuni f.19, të rezultateve të hetimit të Komisionit.

<sup>5</sup> Referohuni prg.3, f.29 të vendimit të Komisionit.

<sup>6</sup> Referohuni prg.9.14, f. 29 të vendimit të Komisionit.

*rast balanca negative e rezultuar në shumën 116.198 lekë nuk impakton në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit [...]*<sup>7</sup>.

15.8 **Komisioneri Publik** e gjen të pabazuar në akte dhe interpretim ligjor qëndrimin e Komisionit, lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme të të ardhurave për investimin në këtë pasuri, konkretisht për dy prej tyre: (i) kursime familjare, në shumën 5.000 euro dhe (ii) ndihmë nga babai i personit të lidhur, në shumën 25.000 euro ose 3.000.000 lekë.

15.9 (i) *Lidhur me kursimet familjare në shumën 5.000 euro*, Komisioni i ka kërkuar subjektit të specifikojë shumën që i përket zërit: *kursime familjare*.

15.9.1 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:<sup>8</sup> *[...] shuma prej 50.000 euro do t'i likuidohej investitores \*\*\*.\*\*\* me marrjen e kredisë nga \*\*\*.\*\*\*, por nga kjo bankë u miratua kredia në shumën 45.000 euro, duke mbetur pa u paguar shuma prej 5.000 euro, shumë e cila nuk është paguar deri aktualisht [...]*.

15.9.2 Komisioni, pasi ka konstatuar se subjekti në DV-2006, kur ka deklaruar këtë kontratë sipërmarrje, nuk ka deklaruar detyrime të mbetura ndaj shoqërisë, ashtu siç pretendon gjatë hetimit administrativ për efekt të procesit të rivlerësimit, e ka pyetur subjektin e rivlerësimit për këtë mospërputhje.

15.9.3 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:<sup>9</sup> *[...] siç rezulton dhe nga dokumentacioni i marrë nga ish-\*\*\*<sup>10</sup>, ne nuk i kemi mbetur asnjë detyrim znj. \*\*\*.\*\*\* (\*\*\*) për prenotimin e apartamentit, pasi edhe shuma prej 5 000 euro është shlyer në të njëjtën ditë me disbursimin e kredisë bankare, në numrin e llogarisë së saj personale (bashkëlidhur akti i bankës)[...]*.

15.9.4 Ndërkohë, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 5000 euro, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:<sup>11</sup> *[...] Pagimi i kësaj shume përputhet plotësisht me deklarin periodik të vitit 2006 në zërin: “kursime familjare”, si pjesë e të ardhurave të përdorura për pagimin e apartamentit, si dhe me faktin se në deklarin periodik pasardhës, nënshkruar e dorëzuar me datë 26.3.2007, kemi pakësim të gjendjes “cash” në banesë, në masën e 450.000 lekë, shumë e cila është përdorur në atë kohë për plotësimin e detyrimit prej 5000 euro ndaj shtetases \*\*\*.\*\*\* (\*\*\*)[...]*.

15.9.5 Bazuar në këto parashtrime të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin se:<sup>12</sup> *[...] Nga verifikimi i dokumentit rezulton se mandati bankar i referohet kohës në të cilën ka ndodhur veprimi dhe, për pasojë, nuk vlerësohen problematika lidhur me shlyerjen e kësaj shume. Po ashtu edhe pakësimi i gjendjes cash në vitin 2006 në koherencë edhe me mosdeklarim të ndonjë detyrimi në vitin 2006, janë fakte të ndodhura në kohë reale dhe që, për pasojë, bëjnë të besueshme likuidimin e mandatit në shumën 5.000 euro [...]*

15.10 Komisioneri Publik, vëren se: (i) në DV-2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash*, që mund të kishin shërbyer si burim i ligjshëm të ardhurash për kryerjen e pagesës në shumën 5000 euro, por ka deklaruar si: *“cash në shtëpi nga kursimet e*

<sup>7</sup> Referohuni prg.2, f. 29 të vendimit të Komisionit.

<sup>8</sup> Referohuni përgjigjeve në pyetësorin nr. 2, gjatë hetimit të Komisionit.

<sup>9</sup> Referohuni pyetësorit nr. 5, gjatë hetimit të Komisionit.

<sup>10</sup> Subjekti ka depozituar mandatin bankar të derdhjes së shumës 5.000 euro në datën 21.3.2006, nga \*\*\*.\*\*\*, në llogarinë bankare të investitores \*\*\* \*\*\* (\*\*\*) , pranë \*\*\* Bank, me përshkrimin: *“\*\*\*.\*\*\* pagesë për blerje apartamenti”*.

<sup>11</sup> Referohuni pyetësorit nr. 5, gjatë hetimit të Komisionit.

<sup>12</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 25 të vendimit.

2006-ës”, shumën prej 500.000 lekë.<sup>13</sup> Nisur nga sa ka deklaruar subjekti në DV-2006, në konsideratë dhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit,<sup>14</sup> për deklarimin e likuiditeteve cash në deklaratat periodike vjetore, vlerësohet se Komisioni duhet të kishte mbajtur një qëndrim ndryshe, duke marrë në konsideratë vetëm sa ka deklaruar subjekti në DV-2006, (ii) nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, deri në datën 21.3.2006, kur është kryer pagesa 5000 euro, rezulton se janë tërhequr në total rreth 250.000 lekë<sup>15</sup>, të cilat nuk janë të mjaftueshme për pagesën e shumës 5.000 euro dhe për mbulimin e shpenzimeve familjare deri në këtë datë.

15.11 Në përfundim, Komisioneri Publik, lidhur me burimin e ligjshëm: “kursime familjare në shumën 5000 euro” konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse rezulton nga rrethanat e parashtruara më lart, ka kryer deklarime të pasakta në DV-2006, deklarime kontradiktore mbi shlyerjen e pagesës 5000 euro, gjatë hetimit administrativ të Komisionit; dhe (ii) nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pagesën e shumës 5000 euro, të kryer në datën 21.3.2006.

15.12(ii) Lidhur me burimin e deklaruar: ndihmë nga babai i personit të lidhur, në shumën 25.000 euro ose 3.000.000 lekë

15.12.1 Në D-Vett., në rubrikën: “Të Dhëna Konfidenciale”, personi i lidhur, z. Mici, ka deklaruar se: [...] Lidhur me shumën prej 25.000 euro, ndihmë nga babai, sqaroj se si burim babai ka përdorur të ardhura nga kontrata e shitjes nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.1995, në shumën 100.000 USD (pronë e trashëguar dhe kthyer nga K.K. Pronave sipas vendimit nr.\*\*\* datë \*\*\*.10.1995). Kontrata e shitjes nr.\*\*\*, datë \*\*\*.8.2000, në shumën 4.500.000 lekë (pronë e trashëguar dhe kthyer nga K.K. Pronave sipas vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.1995)[...].

15.12.2 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma prej 3.000.000 lekë i është dhënë nga babai<sup>16</sup> i personit të lidhur, për blerje apartamenti dhe kjo shumë ka pasur si burim shitjen e pronave të tij të trashëguara.

15.12.3 Komisioni, në referencë të verifikimit të burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, në vlerën 3.000.000 lekë, dhënë nga babai i personit të lidhur, ka arsyetuar se: [...]babai i bashkëshortit të subjektit, sikurse është cituar më sipër, ka rezultuar trashëgimtar testamentar i pasurive të të ndjerit babait të tij, \*\*\*,\*\*\*, dhe si i tillë edhe përfitues i çdo pasurie të kthyer apo kompensuar nga institucioni përkatës i kohës. Nëpërmjet të gjithë kontratave të shitjes, por në rastin konkret kryesisht nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë \*\*\*.8.2000, që ndikonte më së shumti në kohën e dhënies së shumës në formë dhurimi, u provua burimi i të ardhurave të përfituara, si dhe tatimi i paguar mbi to [...].

<sup>13</sup> Subjekti i rivlerësimit në rubrikën: “Ndryshimet e pasurive të luajshme dhe të paluajshme”, ku ka detyrimin të deklarojë shtesat dhe pakësimet e pasurive për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit respektiv, ka deklaruar: “cash në shtëpi nga kursimet e 2006-ës, shuma 500.000 lekë”.

<sup>14</sup> Referohuni vendimit (JR) nr.11/2019, në pikën 27.12.18, prg. 27; Vendimi (JR) nr. 19/2019, prg. 84; Vendimi (JR) nr. 20/2019, prg. 59; Vendimi (JR) nr. 7/2019, prg.39; Vendimi (JR) nr. 27/2020, prg.19.4.v etj.

<sup>15</sup> Nga nxjerrjet e llogarive bankare konstatojmë se, deri në datën 21.3.2006, janë tërhequr nga llogaria bankare e \*\*\*,\*\*\*, në \*\*\* Bank, 148.600 lekë, ndërsa nga llogaria bankare e subjektit në \*\*\* Bank, janë tërhequr 107.000 lekë. Po ashtu, në \*\*\* Bank, konstatohet dhe një tërheqje cash, në shumën 100.000 lekë, për të cilën në pyetësin nr. 5, subjekti ka deklaruar se e ka marrë për t’i ardhur në ndihmë shtetas \*\*\*,\*\*\*.

<sup>16</sup> Në pyetësin nr. 2, gjatë hetimit të Komisionit., deklaroi se: [...] këtë shumë siç kemi deklaruar, e ka dhënë babai i bashkëshortit \*\*\*,\*\*\* dhe jo babai im, gjë e cila është harruar të saktësohet në deklarimin e vitit 2006 dhe bëhet fjalë për të njëjtën shumë të deklaruar si më sipër dhe kjo dykuptimësi ka ardhur për shkak të një gabim material, të bërë nga ana ime, duke harruar të saktësoja se bëhet fjalë për babain e bashkëshortit [...].



15.12.4 Komisioni, pasi në datën 16.7.2020 zhvilloi seancën dëgjimore me subjektin e rivlerësimit dhe e shtyu atë për shpalljen e vendimit, me vendimin nr. 4, datë 24.7.2020, konstatohet se vendosi riçeljen e hetimit për të kërkuar informacion nga organi tatimor, nëse subjekti i rivlerësimit, duhet të paguante apo jo detyrimet tatimore mbi shumën e dhuruar, në vlerën 3.000.000 lekë.

15.12.5 Pas riçeljes së hetimit, mbi kërkesën e Komisionit lidhur me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura, DPT<sup>17</sup> ka parashtuar se: [...] *Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipas rastit të paraqitur, trashëgimtari në momentin e kalimit të pasurisë së paluajtshme (shitje), ka paguar edhe tatimin mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara. Më pas, kur ky individ ka dhënë ndihmë në cash në vlerën 3.000.000 lekë, përfituesi i kësaj shume nuk është subjekt i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Për sa më sipër, përfituesi i ndihmës nuk ka detyrim të paguajë tatim mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara, pasi parimi i tatimeve është që e njëjta shumë nuk mund të tatóhet dy herë [...].*

15.12.6 Subjekti i rivlerësimit, po në datën 24.7.2020, ka depozituar pranë Komisionit, aktin përkatës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara, në shumën 3.000.000 lekë, pagesë e cila është kryer pranë \*\*\* Bank, në datën 24.7.2020.

15.12.7 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *kjo e ardhur nuk mund të kualifikohet as edhe sipas germës "g", të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin për të ardhurat" (të ndryshuar), si dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, "Për tatimin për të ardhurat" (të ndryshuar), për sa kohë këto të ardhura nuk janë nga aktivitetet përmes së cilit mund të siguroheshin të ardhura tatimore shtesë. Trupi gjykues çmon se në bazë të dispozitave ligjore të lartpërmendura, përderisa për këtë të ardhur është paguar tatimi, vlerësimi ndryshe do kishte kualifikimin e pagesës së një tatimi të dyfishtë, veprim i cili del përtej parashikimit ligjor. Në rastin objekt hetimi, tjetërsimi i pasurisë ka ndodhur nga vjehri i subjektit dhe, për pasojë, edhe tatimi është paguar prej tij, ndërsa është dhuruar një vlerë monetare, si e ardhur neto, që buron nga ky tjetërsim. Në vijim, Komisioni ka arsyetuar se të paguarit e tatimit në mënyrë permanente, pra, nga një dhurues te tjetri, nëse kjo do të ndodhte, do të sherohej vlera përbërëse e vetë objektit të dhurimit, atëherë dhurimi do të humbiste qëllimin që ky veprim nënkupton në vetvete. Nga ana tjetër, interpretimi ndryshe i këtij kualifikimi ligjor, në asnjë rast, nuk është hasur as në praktikën zbatuese të institucioneve tatimore. Trupi gjykues, me kompetencat që i jep Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016, pa u kushtëzuar nga informacioni i përcjellë nga organi tatimor, por as edhe nga veprimet e ndërmarra nga subjekti, por duke u bazuar ekzaktësisht në legjislacionin e fushës, konkludon se kjo e ardhur nuk mund t'i nënshtrohet tatimit. Lidhur me këtë çështje objekt vlerësimi, për çdo interpretim ndryshe, apo boshllëk ligjor, nëse kjo e ardhur do t'i nënshtrohej tatimit, Komisioni ka konstatuar se legjislacioni tatimor me zhvillimet e tij ka synuar të qartësojë përjashtimin nga ky tatim për çështje të cilat burojnë kryesisht nga marrëdhëniet familjare [...].*

15.13 Komisioneri Publik, vëren se: (i) lidhur me pagesën e tatimit gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>18</sup>, pagesa e detyrimeve tatimore në datën

<sup>17</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\*, datë \*\*\*.7.2020.

<sup>18</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2019, prg. 63; vendimit (JR) nr. 05/2020 prg. 41.9; vendimit (JR) nr. 23/2020 prg. 24.13.

24.7.2020, për të ardhurat e dhuruara në vitin 2006, në shumën 3.000.000 lekë, konsiderohet e paefektshme në funksion të procesit të rivlerësimit dhe, si e tillë, kjo shumë nuk duhet përfshirë në mesin e burimeve të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit me sip.104 m<sup>2</sup>; (ii) nuk rezulton e provuar mënyra e përfitimit/transaksioni i kryer, i cili lidh burimin e ligjshëm të të ardhurave nga kontratat e shitjes të v. 1995 dhe v. 2000, me dhurimin prej 3.000.000 lekë në vitin 2006; (iii) kontratat e shitjeve të pasurive të paluajtshme në periudhën 1995-2006, të realizuara nga z. \*\*\*.\*\*\*, të ardhurat nga shitja e të cilave pretendohen si burim i ligjshëm për dhurimin e kësaj shumë, rrjedhin nga një titull i pronësisë të subjektit të shpronësuar, z. \*\*\*.\*\*\* (disa trashëgimtarëve të tij) dhe një titull pronësie në emër të z. \*\*\*.\*\*\*.

15.14 Bazuar në këto rrethana fakti dhe ligji, referuar jurisprudencës përkatëse të Kolegjit, ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, Komisioneri Publik vlerëson se, lidhur me verifikimin e ekzistencës së të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për pagesat e pasurisë: apartament me sip.104 m<sup>2</sup>: (i) shuma 500.000 lekë, referuar deklarimeve të subjektit në DV-2006, duhet konsideruar shtesë e likuiditeteve *cash* në këtë vit, ashtu sikurse ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore përkatëse; (ii) nuk duhet përfshirë në zërin e të ardhurave të ligjshme shuma 3.000.000 lekë, pasi detyrimet tatimore lidhur me këtë shumë janë paguar kohë më vonë nga përfitimi i kësaj shume dhe për efekt të procesit të rivlerësimit.

**16.** Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vitin 2006, kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në pasuri, për të kursyer shumën 500.000 lekë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, në total në shumën - 4.066.211 lekë.

#### **17. Lidhur me analizën financiare**

17.1 Nga aktet e administruara në dosje<sup>19</sup>, konstatojmë se Komisioni ka kryer analizën financiare paraprake për të vlerësuar mundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme të investimeve, kursimeve dhe shpenzimeve të realizuara nga familja e subjektit të rivlerësimit.

17.2 Nga kjo analizë financiare, Komisionit, fillimisht, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ishte në balancë negative për vitet 2005, 2010 dhe 2012-2014, në shumën totale prej - 921.345 lekë për të përballuar të gjitha shpenzimet familjare<sup>20</sup>.

17.2.1 Konstatohet se në analizën e kryer nga Komisioni: (i) janë përfshirë në zërin e të ardhurave të ligjshme shumat 300.000 lekë/vit, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si *ndihmë financiare nga babai i personit të lidhur*, si dhe (ii) janë përlogaritur pakësime të kursimeve *cash*, në shumat 450.000 lekë në vitin 2006, 500.000 lekë në vitin 2007, dhe 300.000 lekë në vitin 2016, të cilat do të trajtohen në vijim.

17.2.2 Për shumat 300.000 lekë/vit, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si *ndihmë financiare e dhënë nga babai i personit të lidhur*, Komisioni ka arsyetuar<sup>21</sup> se: [...] *Subjekti ka qartësuar se ligjërisht nuk është i parashikuar detyrimi për deklarimin e kësaj lloj forme të marrjes së këtij përfitimi...Trupit gjykues nisur nga hetimi i kryer për të ardhurat e krijuara nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, përveçse i ka rezultuar se ky i fundit ka realizuar të ardhura të konsiderueshme nga shitja e pasurive të paluajtshme, nga ana tjetër nuk i ka rezultuar sipas korrespondencave institucionale të administruara në dosjen*

<sup>19</sup> Referohuni analizës financiare gjatë hetimit të Komisionit.

<sup>20</sup> Referohuni f. 38 të vendimit të Komisionit, prg.15.2.

<sup>21</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 34 e vendimit.

*e hetimit administrativ që të ketë kryer investime në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme. Në këtë këndvështrim, trupit gjykues i krijohet bindja se vjehri i subjektit ka qenë në kushte të tilla financiare për të mundësuar dhënien e kësaj shume vit pas viti subjektit [...].*

17.3 Referuar rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë argumentet në lidhje me rezultatet e analizës financiare<sup>22</sup>.

17.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Në analizën financiare të paraqitur me prapësimet, kam marrë në konsideratë: (i) mundësinë për të kursyer cash në vitin 2003 dhe 2004 gjithsej 500,000 lekë; (ii) llogaritjen e shpenzimeve jetike sipas ILDKPKI-së sipas numrit të pjesëtarëve të familjes, duke pasur parasysh se vajza ka lindur me \*\*\* korrik 2010 (vetëm për 5 muaj shpenzime), ndërsa (iii) për djalin e kam shpjeguar dhe më lart që ka jetuar me prindërit e mi dhe nuk duhet të përfshihet në masën e shpenzimeve jetike [...].*

17.5 Komisioni, duke marrë në konsideratë pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, lidhur me shpenzimet e jetesës, ka rishikuar analizën financiare, nga ku subjekti ka rezultuar me një pamjaftueshmëri totale në shumën - 492.594 lekë<sup>23</sup> për gjithë periudhën 2005-2016.

17.6 Komisioni, në këto kushte, ka ardhur në përfundimin se: [...] *Balanca negative në shumën 492.594 lekë, balancë e shpërndarë në vite, në raport me një vlerësim të përgjithshëm të kriterit të pasurisë dhe duke mbajtur në vëmendje parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak për aplikimin e ndonjë mase penalizuese ndaj subjektit të rivlerësimit [...]*<sup>24</sup>.

17.7 Komisioneri Publik e gjen të pabazuar, në akte dhe interpretim ligjor, vlerësimin e Komisionit mbi mundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme, të krijuara nga burime të ligjshme, të kursimeve dhe shpenzimeve të realizuara nga familja e subjektit të rivlerësimit në vitet 2005-2016, për këto elemente: (i) të ardhurat e pretenduara si *ndihmë financiare nga babai i personit të lidhur*; (ii) likuiditetet *cash*; (iii) shpenzimet jetike të familjes së subjektit të rivlerësimit.

17.8 (i) Të ardhurat e pretenduara si: *“Ndhmë financiare nga babai i personit të lidhur”*, në shumat prej 300.000 lekë/vit.

17.8.1 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, gjatë plotësimit të deklaratave përgjatë viteve 2005-2016, në rubrikën: *“Dhurata dhe Trajtime Preferenciale”*, me vlerën mbi 10.000 lekë<sup>25</sup>, të kenë deklaruar të ardhura të përfituara nga babai i personit të lidhur për përballimin e shpenzimeve të jetesës.

17.8.2 Deklarimi i këtyre të ardhurave të pretenduara, që Komisioni i ka përlllogaritur si të ardhura të ligjshme, ka qenë detyrim ligjor për deklaram, parashikuar nga legjislacioni përkatës, që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur e kanë mbartur gjatë plotësimit të përvitshëm të deklaratave pranë ILDKPKI-së dhe atë Vetting.

<sup>22</sup> Referohuni f. 27 të rezultateve të hetimit.

<sup>23</sup> Kjo pamjaftueshmëri përfshin jo vetëm pamjaftueshmërinë e viteve 2005, 2010, 2012-2014, por edhe pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitet 2006 dhe 2016.

<sup>24</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit, f.39-40 të vendimit.

<sup>25</sup> Detyrim ligjor i parashikuar nga ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, dhe ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar.

17.8.3 Sa më sipër, shumat 300.000 lekë/vit nuk duhen përfshirë në zërin e të ardhurave ndër vite, për sa kohë ka rezultuar se nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, në referencë kjo të nenit 32/5, të ligjit nr. 84.2016, dhe të jurisprudencës të konsoliduar të Kolegjit,<sup>26</sup> mbi vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore, në procesin e rivlerësimit.

17.9 (ii) *Likuiditetet cash*. Komisioneri Publik vëren se Komisioni, në analizën financiare për vitet 2006, 2007 dhe 2016, ka pakësuar likuiditetet *cash*, në shumën 450.000 lekë në vitin 2006, 500.000 lekë në vitin 2007 dhe 300.000 lekë në vitin 2016, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit znj. Mici, në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar vetëm shtesa të kursimeve *cash*<sup>27</sup> dhe në asnjë prej këtyre deklaratave nuk ka deklaruar pakësime të kursimeve në *cash*.

17.9.1 Komisioneri Publik vlerëson se përllogaritjet e Komisionit lidhur me likuiditetet *cash* nuk përputhen me çfarë ka deklaruar subjekti në deklaratimet periodike vjetore dhe bien ndesh edhe me orientimin e Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 7/2019, prg. 39., si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>28</sup>, pasi këto deklarata përbëjnë të vetmen provë dhe mënyrë verifikimi të ekzistencës së likuiditeteve *cash* në funksion të procesit të rivlerësimit.

17.10 (iii) *Shpenzimet e jetesës*. Komisioneri Publik vëren se Komisioni, në analizën financiare përfundimtare, ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e jetesës dhe ka reduktuar për të gjithë periudhën e analizuar shpenzimet e jetesës së djalit të subjektit të rivlerësimit<sup>29</sup>.

17.10.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit duhen llogaritur bazuar në përbërjen familjare të subjektit, të deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse, duke përjashtuar vitet 2006 dhe 2007, në të cilat subjekti i ka vetëdeklaruar këto shpenzime.

17.11 Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, përveç sa më sipër trajtuar, vëren se: (i) lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat si avokat, duhet të merret në konsideratë fitimi *pas tatimit* për vitet 2014-2015, përkatësisht 153.593 lekë në vitin 2014 dhe 2.850.220 lekë në vitin 2015<sup>30</sup>; (ii) likuiditetet në llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortit, në datën 31.12.2007 janë në total në shumën -25.490 lekë<sup>31</sup>.

17.12 Në përfundim, Komisioneri Publik, nga rivlerësimi i këtyre elementeve të analizuara më lart, të analizës financiare për periudhën 2005-2016, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitet 2005, 2007 dhe 2009-2014, nuk mbulojnë më të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet në këto vite, për një diferencë totale negative prej - 3.256.276 lekë.

<sup>26</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 6/2018, prg.14; vendimit (JR) nr. 8/2018, prg. 43; vendimit (JR) nr.12/2018, prg. 24.11; vendimit (JR) nr. 5/2019, prg. 23; vendimit (JR) nr.10/2018, prg. 67; vendimit (JR) nr. 19/2019, prg. 22.14.

<sup>27</sup> Në DV-2005, subjekti ka deklaruar: *likuiditete në cash, 950.000 lekë*; në DV-2006 ka deklaruar: *cash në shtëpi nga kursimet e 2006-ës, 500.000 lekë* dhe në DV-2015 ka deklaruar: *cash në shtëpi për shpenzime të zakonshme, 300.000 lekë*.

<sup>28</sup> Referohuni vendimeve (JR) nr. 27/2020, prg. 19.4.v; (JR) nr. 19/2019, prg. 84; (JR) nr. 11/2019, prg. 27.12.18.

<sup>29</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit lidhur me shpenzimet e jetesës në f. 21 të vendimit.

<sup>30</sup> Rezulton që Komisioni ka përfshirë në zërin: *të ardhura*, fitimin e tatueshëm, ndërkohë që nga këto shuma duhet të ishte zbritur tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, që referuar akteve bashkangjitur shkresës së DRT Tiranë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2017, është përkatësisht 16.667 lekë në vitin 2014 dhe 231.099 lekë në vitin 2015. Ndërsa në vitin 2016, tatimi mbi fitimin e deklaruar është (0) zero.

<sup>31</sup> Balanca e llogarisë bankare nr. \*\*\*, në emër të subjektit të rivlerësimit, nuk është në shumën + 79.802 lekë, sa është llogaritur nga Komisioni, por është në shumën -79.802 lekë. Gjithashtu, balanca e llogarisë bankare nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortit të subjektit, në \*\*\* Bank, nuk është në shumën 83.869 lekë, por në shumën 53.869 lekë, pasi rezulton se në 31.12.2007, nga kjo llogari është tërhequr *cash* shuma 30.000 lekë.

## 18. Pasuri e luajtshme, automjet tip “Audi A4”, me targa AA\*\*\*

18.1 Në D-Vett., personi i lidhur, z. Mici, ka deklaruar: Automjet tip “Audi A4”, me targa AA\*\*\*, blerë në mars të vitit 2016. Burimi i krijimit: me të ardhurat nga puna si avokat. Vlera, 8.000 euro. Pjesa takuese 100%.

18.2 Në DV-2016, personi i lidhur ka deklaruar: [...]Automjet tip “Audi A4”, me targa AA\*\*\*, blerë në mars të vitit 2016. Burimi i krijimit: me të ardhurat nga puna si avokat. Vlera: 8.000 euro. Pjesa takuese 100% [...]. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “Të Dhëna Konfidenciale”, personi i lidhur deklaroi: [...] *Lidhur me burimin e krijimit të automjetit sqarohet se shuma prej 6.000 euro i është marr hua z. \*\*\*.\*\*\*, në momentin e blerjes dhe është shlyer në datën \*\*\*.11.2016, me të ardhurat nga puna si avokat [...].*

18.3 Në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, është administruar: (i) shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, përmes së cilës konfirmohet se shtetasi \*\*\*.\*\*\* ka në pronësi mjetin me targë: AA\*\*\* dhe përcjell të plotë praktikën dokumentare; (ii) kontrata e huas nr. \*\*\* , datë \*\*\*.11.2016, me palë huadhënëse \*\*\*.\*\*\* dhe palë huamarrëse \*\*\*.\*\*\*, me objekt një shumë parash në formën e huas pa interes, në masën 6.000 euro, dhënë me datë \*\*\*.3.2016, nëpërmjet MoneyGram; (iii) deklarata noteriale nr. \*\*\* , datë \*\*\*.11.2016, ku shtetasi \*\*\*.\*\*\* deklaroi se huaja në shumën 6000 euro është shlyer tërësisht ditën e sotme nëpërmjet pagesës bankare; (iv) transaksioni bankar i datës \*\*\*.11.2016, nga llogaria e \*\*\*.\*\*\* P. F., në “\*\*\* Bank”, në favor të \*\*\*.\*\*\* me përshkrimin: “*kalim borxhi sipas kontratës nr. \*\*\* , datë \*\*\*.11.2016*”; (v) shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë (DRT) nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2020, nga ku rezultoi i regjistruar subjekti tregtar “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin \*\*\*.\*\*\*; (vi) shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Gjirokastër, nga ku rezultoi se shtetasi \*\*\*.\*\*\* figuroi administrator i subjektit “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k.; (vii) shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2020, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), që konfirmon pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën dhjetor 2012- dhjetor 2014.

18.4 Konstatohet se Komisioni ka hetuar lidhur me mundësitë financiare të shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe i ka rezultuar se ky shtetas ka qenë ortak dhe administrator në disa shoqëri tregtare. ISSH-ja konfirmon se huadhënësi ka qenë i siguruar deri në dhjetor të vitit 2014. Nga analizimi i *statement*-it bankar të \*\*\* Bank, Komisionit i ka rezultuar se këtij shtetasi i është transferuar në datën \*\*\*.10.2015, shuma prej 7000 euro, si këst për blerje apartamenti dhe, po në të njëjtën datë, kjo shumë është tërhequr prej tij.<sup>32</sup>

18.5 Në vijim, Komisioni ka kryer analizën financiare vjetore të vitit 2016, duke analizuar në të njëjtën kohë edhe kthimin e huas në shumën prej 6.000 euro, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në shumën - 407.176 lekë: (i) për të investuar në blerjen e kësaj pasurie; (ii) për të shlyer huan, si dhe: (iii) për të përballuar shpenzimet e tjera. Lidhur me këtë konstatim, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë argumente dhe prova.

<sup>32</sup> Referohuni prg.8.6.2, f. 19 të vendimit të Komisionit.

18.6 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka pretenduar:<sup>33</sup> [...] *Në raport me shpenzimet jetike të llogaritura për vitin 2016, ato janë llogaritur më shumë se sa duhet në realitet, pasi pretendoj se këto shpenzime sipas ILDKPKI-së të llogariten për tre persona dhe jo për katër, kjo pasi siç kam shpjeguar në përgjigje të pyetësorëve, mbështetur edhe në dokumentacionin e shkollës së djalit si akte provuese, \*\*\*.\*\*\*, i datëlindjes \*\*\*.4.2001, që në moshë të vogël (1 vjeç), për arsye shëndetësore ka jetuar dhe është mbajtur nga prindërit e subjektit në fshatin \*\*\*, Durrës[...].*

18.7 Komisioni, pasi ka administruar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, arsyeton se:<sup>34</sup> [...] *Në analizë të dokumentacionit të depozituar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, rezulton se në tërësi ka pasur mundësi të krijojë dhe të japë në favor të bashkëshortit të subjektit shumën prej 6.000 euro për blerjen e automjetit. Në këto kushte, trupi gjykues krijon bindjen se huadhënësi ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për të dhënë hua bashkëshortit të subjektit... Ndërsa në lidhje me pretendimin e subjektit për të përlllogaritur në analizën financiare, tre persona në familjen e saj, në zërin e shpenzimeve të jetesës, për shkaqet dhe arsyet e përmendura në parashtrime lidhur me rritjen e djalit të saj pranë prindërve të saj, trupi gjykues vlerëson deklaratimet konsistente të saj, se djali që nga moshë 1-vjeçare është rritur në fshatin \*\*\*, Durrës, nga dy prindërit e saj... Në kushte të tilla, trupi gjykues, mbi arsyetimin e lartpërmendur, kreu përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor rillogaritjet financiare, nga ku subjekti rezultoi në balancë negative nga 407.176 lekë në 172.084 lekë, shumë kjo që nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit [...].*

18.8 Komisioneri Publik e gjen të pabazuar, në akte dhe interpretim ligjor, vlerësimin e Komisionit mbi: (i) mundësinë e huadhënësit për të dhënë nga burime të ligjshme, të ardhura të ligjshme në shumën 6000 euro dhe (ii) pamjaftueshmërinë e konstatuar, në shumën - 172.284 lekë për të investuar në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, për të shlyer huan, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare për vitin 2016.

18.9 (i) Mbi mundësinë e huadhënësit për të dhënë nga burime të ligjshme, të ardhura të ligjshme shumën 6000 euro, konstatohet se: (i) nga informacioni i administruar nga DRT, Tiranë rezulton se, sipas të dhënave të dorëzuara në sistemin tatimor, qarkullimi dhe fitimi i realizuar nga subjekti tregtar “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin \*\*\*.\*\*\* është zero lekë, subjekti ka detyrime të pashlyera dhe është me status pasiv që nga data \*\*\*.5.2016; (ii) nga informacioni i administruar nga DRT Gjirokastër rezulton se subjekti “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin \*\*\*.\*\*\*, nuk ka tërhequr dividendë, ka detyrime të pashlyera dhe figuron me status pasiv që prej datës \*\*\*.10.2014; (iii) nga informacioni i administruar nga ISSH-ja rezulton se shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në periudhën dhjetor 2012 – dhjetor 2014, ka përfutur të ardhura bruto në shumën 21.000-22.000 lekë në muaj.

18.9.1 Sa më sipër, nga aktet e administruara, duket se shtetasi \*\*\*.\*\*\* nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë personit të lidhur, z. Mici, hua shumën 6000 euro.<sup>35</sup>

<sup>33</sup> Referohuni prapësimeve të subjektit në dosje të Komisionit, f. 7.

<sup>34</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit, në f. 21 të vendimit.

<sup>35</sup> Mbi diferencën e mbetur të çmimit të blerjes prej 2.000 euro dhe shpenzimeve doganore në vlerën 229.237 lekë, nga nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. Mici, konstatohet se gjatë periudhës \*\*\*.1.2016 deri në momentin e blerjes së automjetit, më datë \*\*\*.3.2016, nuk janë kryer tërheqje, *cash*. Gjithashtu, të ardhurat e personit të lidhur, z. Mici nga aktiviteti i avokatisë, në shumën 3.191.501 lekë, janë vjetore dhe nuk mund të identifikohet pjesa e të ardhurave të realizuara deri në datën e blerjes së automjetit.

18.10 (ii) Mbi pamjaftueshmërinë në shumën - 172.284 lekë, konstatohet se në analizën financiare të kryer nga Komisioni,<sup>36</sup> për vitin 2016, siç është arsyetuar dhe më sipër në paragrafët 17.8, 17.9 dhe 17.10: (i) shuma 300.000 lekë, “*ndihmë financiare nga vjehri*”, nuk duhet përfshirë në zërin të ardhura, pasi këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën Vetting; (ii) shpenzimet e jetesës për vitin 2016 duhen llogaritur për 4 persona, bazuar në përbërjen familjare sipas certifikatës së gjendjes civile; (iii) zëri “*ndryshimi në likuiditete*” duhet llogaritur në shumën 1.925.783 lekë<sup>37</sup>, pasi nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar në DV-2016, pakësim të likuiditeteve *cash* në shumën 300.000 lekë.

18.11 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe nëse përfshijmë në analizën financiare të vitit 2016 huan në shumën 6.000 euro, përsëri rezulton se në vitin 2016 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në pasurinë automjet “*Audi A4*”, për të shlyer huan, si dhe për të mbuluar kursimet dhe shpenzimet e tjera familjare, në total për një diferencë negative në shumën - 1.007.151 lekë.

18.12 Gjithashtu konstatohet se në “*Formularin e Deklarimit të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin*”, të dorëzuar nga personi fizik, “*\*\*\*\*.\*\*\**”, për vitin 2016, nuk është deklaruar shuma e tatim-fitimit, por është deklaruar vetëm fitimi i tatueshëm ose fitimi para tatimit. Nëse nga fitimi i deklaruar do të zbritet edhe tatim-fitimi i paguar, atëherë të ardhurat neto nga aktiviteti i avokatisë për vitin 2016 do të reduktoheshin, si rrjedhim, do të thellohej edhe diferenca negative e vitit 2016.

**19.** Në përfundim, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik, sa më sipër argumentuar në shkaqet e ankimit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimet, shpenzimet dhe kursimet gjatë periudhës 2005-2016, me një diferencë negative në total prej - 8.329.638 lekë, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, si dhe nenit 33, pika 5, germa “*b*” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

### ***II.C Për vlerësimin e aftësive profesionale***

**20.** Në kuptim edhe të qëllimit të shpallur në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës, e cila parashikon se: [...] *sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi* [...], Komisioneri Publik vlerëson se verifikimi i kriterëve të vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si një proces që përcakton standardin e tyre në përmbushje të detyrës apo gradën e vlerësimit të tyre, zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si edhe te garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës.

**21.** Kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për qëllim të procesit të rivlerësimit, e gjejmë të rregulluar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, dhe për subjektet që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit përfshihen elemente si aftësia për të gjykuar, aftësitë organizative, etika dhe

<sup>36</sup> Referohuni analizës financiare të administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>37</sup> Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2016, f. 6, e rezultateve të hetimit zëri: “*ndryshim likuiditeti*” është llogaritur në vlerën 1.625.782 lekë, pasi rezulton të jenë pakësuar kursimet *cash* në shumën 300.000 lekë, pakësim që nuk rezulton të jetë deklaruar në DIPV nga subjekti.

angazhimi ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimi profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj.

**22.** Ndërkohë, në nivel ligjor, referuar nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale fokusohet në vlerësimin e veprimtarisë etike të subjektit dhe atë profesionale, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016, i ndryshuar.

**23.** Në referencë të sa më sipër, në dosje të Komisionit gjenden të administruara, këto akte burim vlerësimi, hartuar ndër të tjera nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit: (i) raporti për vlerësimin e aftësive profesionale, hartuar nga organi i vlerësimit të aftësive profesionale, KLGJ; (ii) informacion nga Ministria e Drejtësisë; (iii) denoncime nga publiku dhe informacione mediatike kundrejt subjektit të rivlerësimit, administruar nga Komisioni, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016; (iii) dosje gjyqësore, si rezultat i informacioneve të përcjella nga DSIK-ja.

**24.** Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse të tilla që të provojnë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga aktet e administruara, akte këto që duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për sa në vijim:

**25. Dosja nr. 4<sup>38</sup>, e shortuar sipas pikës 2, të nenit 43, të ligjit nr. 84/2016/ Vendim penal nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në të cilën subjekti ka pasur funksionin e gjyqtarit të vetëm, vendim i formës së prerë.** Vlerësimi profesional i subjektit për këtë dosje gjyqësore është pjesë e raportit për vlerësimin e aftësive profesionale, hartuar nga organi ndihmës në rivlerësimin e aftësive profesionale, KLGJ.

25.1 Komisioni, bazuar në pikën 2, të nenit 43, të ligjit nr. 84/2016, ka administruar aktin: “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarës Anita Mici”, të datës \*\*\*.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku vendimi i mësipërm listohet si: “dosja nr.4” (faqet 19-23 e Raportit), që i përket çështjes penale nr.\*\*\* regj. them., datë \*\*\*.11.2014 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

25.2 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, referuar përmbajtjes së vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.03.2015, konstatohet se shtetasi \*\*\*.\*\*\* është dërguar për gjykim nga organi i prokurorisë si i akuzuar për kryerjen e tri veprave penale: (i) “Ndërtim i paligjshëm”, neni 199/a, paragrafi 2 i Kodit Penal (procedimi penal nr.\*\*\*, datë \*\*\*.10.2013); (ii) “Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, neni 137, pika 1 e Kodit Penal (procedimi penal nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.2014); (iii) “Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, neni 137, paragrafi 1 i Kodit Penal (procedimi penal nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.2014, regjistruar fillimisht nga organi procedues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë).

25.3 Referuar akteve të administruara dhe vendimit gjyqësor të çështjes, objekt vlerësimi, në lidhje me kryerjen e veprës penale: “Ndërtim i paligjshëm”, është pranuar e provuar se, bazuar në informacionin e INUV Durrës, datë \*\*\*.10.2013, në zonën bregdetare afër Shkëmbit të Kavajës, po ndërtohej pa leje një objekt shumëkatësh nga i gjykuari, për të cilin kanë filluar veprimet për prishje më datë \*\*\*.5.2014. Ndërkohë, shërbimet e policisë, më datë \*\*\*.7.2014,

---

<sup>38</sup> “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarës Anita Mici”, për periudhën 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, përgatitur nga KLGJ-ja me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2019.



kanë konstatuar se po ndërtohej një mur rrethues mbi katin e nëndheshëm, që kishte ngelur nga prishja.

25.4 Për veprën penale: “Vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, episodi i parë, është pranuar e provuar se: (i) i gjykuari ka qenë i pajisur me kontratë nr. \*\*\*, objekti privat pallat 25-katësh, (ii) nga ana e CEZ-it është konstatuar debia në shumën 1.824.387 lekë për periudhën 2011-2014 dhe i është ndërprerë lidhja me energji elektrike. Pas kontrollit për herë të dytë është konstatuar se është rilidhur energjia elektrike në mënyrë të paligjshme dhe është bërë kallëzimi penal në organin procedues.

25.5 Për veprën penale: “Vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, episodi i dytë, është pranuar e provuar se: (i) i gjykuari ka qenë i pajisur me kontratë nr. \*\*\*, objekti privat - kantier ndërtimi- në zonën e \*\*\*.\*\*\*, Plazh Durrës, (ii) nga ana e CEZ-it është konstatuar debia në shumën 594.082.045 lekë, për periudhën 2011-2014, (iii) i është kërkuar pagimi i saj dhe i është ndërprerë lidhja me energji elektrike. Pas kontrollit për herë të dytë është konstatuar se është rilidhur energjia elektrike në mënyrë të paligjshme dhe është bërë kallëzimi penal në organin procedues.

25.6 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2015, ka vendosur: [...]Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*.\*\*\* për veprat penale: “Ndërtim i paligjshëm” dhe “Vjedhje e energjisë elektrike”, 2 herë [...] dhe pas aplikimit të bashkimit të dënimeve (neni 55 i K. Penal) dhe uljen e dënimeve (neni 406 i K. Pr. Penal), përfundimisht e ka dënuar me 1 vit burgim, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...]veprat penale të parashikuara në nenet 199/a/2 dhe 137/1 të Kodit Penal janë vepra penale me rrezikshmëri shoqërore mesatare... se rrethana rënduese nuk u provuan në gjykim... ndërsa si rrethanë lehtësuese ka renditur edhe moshën e të pandehurit [...].

25.7 Në Raportin e datës \*\*\*.12.2019. KLGJ-ja, në cilësinë e organit ndihmës të institucioneve të rivlerësimit, ka analizuar në mënyrë të detajuar këtë vendim dhe në përfundim parashtron se: [...]vihet re se të dyja veprat penale janë shumë të përhapura dhe i pandehuri \*\*\*.\*\*\*, paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore, ai ka kryer veprimet e kundërligjshme me përsëritje për të dyja veprat penale, ushtron aktivitet privat në plazhin e Durrësit në një objekt 25 kate dhe dëmi i shkaktuar me energjinë elektrike për periudhën 2011-2014 arrin në shumën 548.082.045 lekë...masa e dënimit nuk është në proporcion mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik apo dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar, si dhe synimit që kërkon të arrijë dënimi penal. Në këtë kuptim, masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në keqinterpretim të nenit 47 dhe 55 të K. Penal dhe, për rrjedhim, ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K. Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës[...].

25.8 Komisioni, pasi ka administruar vendimin gjyqësor objekt vlerësimi, si dhe ka marrë në konsideratë opinionin e organit ndihmës KLGJ, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegimet e saj.

25.9 Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] ka caktuar një dënim proporcional dhe në respektim të përcaktimeve të nenit 55/3 të Kodit Penal, duke caktuar për të pandehurin dënimin më të rëndë të shtuar. Ajo ka sqaruar se dënimi penal nuk mund të jetë mbledhje matematike e dënimeve të caktuara veç e veç për çdo vepër penale, pasi kjo vjen ndesh me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konsideruar në shkelje të parimeve kushtetuese caktimin e dënimit bazuar në mbledhje matematike të dënimeve të veçanta...Përveç kësaj, në rastin konkret, ndryshe nga sa

*pretendohet, veprat penale dhe autori nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Ky i pandehur do të mund të konsiderohej përsëritës në kryerjen e veprës penale (fakt që rrit rrezikshmërinë shoqërore të tij), vetëm në rast se më parë kishte kryer një tjetër vepër penale për të cilën të ishte deklaruar fajtor dhe dënuar, dhe jo kur ai më parë ka konsumuar një shkelje me natyrë administrative. Përsëritës në kuptim të ligjit penal, subjektin e bën vetëm dënimi penal i mëparshëm dhe jo dënimi administrativ. Nga ana tjetër, të dyja veprat penale në këtë rast janë kryer nga një i pandehur në një moshë të madhe dhe këtu, në zbatim të nenit 49 të Kodit Penal, është vlerësuar moshja e tij, sikurse edhe gjendja shëndetësore që ka paraqitur që në fazën e hetimit, që kanë qenë shkak që i pandehuri të hetohet e gjykohet me masë sigurimi “arrest në shtëpi” [...].*

25.10 Komisioni, pasi ka administruar dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar se: [...] *nisur edhe nga fakti se vendimet e dhëna kanë mbetur në fuqi dhe se për to nuk janë konkluduar zvarritje të qëllimshme të procesit, çka do të pasqyronin anën procedurale të procesit gjyqësor apo probleme të tjera të natyrës procedurale, në tërësi nën argumentet e lartpërmendura, krijon bindjen se pretendimet e subjektit faktohen dhe në këtë këndvështrim nuk konstatohen problematika që të ndikojnë në vlerësimin profesional të saj [...].*

25.11 Komisioneri Publik, në analizë të fakteve, rrethanave dhe akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, vlerëson se:

25.11.1 Për sa i përket veprës penale, asaj të: “Vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, neni 137, paragrafi 1 i Kodit Penal, kryer dy herë, referuar: (i) faktit të rilidhjes së energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, pasi ndaj të gjykuarit ishte marrë sanksioni administrativ i ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike dhe (ii) vlerës së madhe të debisë, në të dyja rastet e konstatuara, duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuar nga KLGJ-ja, në cilësinë e organit ndihmës në lidhje me konstatimin se: [...] *masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në keqinterpretim të nenit 47 dhe 55 të K. Penal, dhe për rrjedhim ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K. Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës [...].*

25.11.2 Për sa i përket veprës tjetër penale: “Ndërtimi i paligjshëm”, neni 199/a, paragrafi 2 i Kodit Penal, referuar faktit se i gjykuari konstatohet se edhe këtë vepër penale e ka kryer pasi ndaj tij ishte zbatuar sanksioni administrativ i prishjes së ndërtimit të paligjshëm, objekt 25 kate, duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuar nga KLGJ-ja, në cilësinë e organit ndihmës në lidhje me konstatimin se: [...] *masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në keqinterpretim të nenit 47 dhe 55 të K. Penal, dhe për rrjedhim ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K. Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës [...].*

25.12 Referuar rolit dhe kompetencës të institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit<sup>39</sup>, referuar kritereve vlerësuese të parashikuara në

<sup>39</sup> Vendimin orientues (JR) nr. 21/2019 Kolegjit të Posaçëm të Apelit, prg. 26.1.1. [...] *Trupi gjykues i Kolegjit çmon të nevojshme që, nëpërmjet arsyetimit të plotë të vendimit që lidhet me këtë çështje, të japë edhe orientimet e tij në lidhje me kryerjen e procesit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, me qëllimin për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni, kur është e mundur dhe e nevojshme, duhet të administrojë të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në nenet 71, 72, 74, 75, 76, të ligjit nr. 96/2016, dhe, njëkohësisht, duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, bazuar në treguesit përkatës në analogji me vlerësimin e aftësive*

ligjin nr. 96/2016, për sa argumentohet më lart, Komisioneri Publik konstaton mungesë të arsyetimit ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me caktimin e masës së dënimit në vendimin objekt vlerësimi.

**26. Dosja nr.5<sup>40</sup>, e shortuar sipas pikës 2, të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016/ Vendim penal nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në të cilën subjekti ka pasur funksionin e gjyqtarit të vetëm, vendim i formës së prerë.** Vlerësimi profesional i subjektit për këtë dosje gjyqësore është pjesë e raportit për vlerësimin e aftësive profesionale, hartuar nga organi ndihmës në rivlerësimin e aftësive profesionale, KLGJ.

26.1 Komisioni, bazuar në pikën 2, të nenit 43, të ligjit nr. 84/2016, ka administruar aktin “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarës Anita Mici” të datës \*\*\*.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku vendimi i mësipërm listohet si “dosja nr.5” (faqet 24-27 e Raportit), që i përket çështjes penale nr.\*\*\* regj. them., datë \*\*\*.10.2015 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

26.2 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, referuar përmbajtjes së vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.10.2015, konstatohet se shtetasi \*\*\*.\*\*\* është dërguar për gjykim nga organi i prokurorisë si i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Kontrabandë me mallra që paguhet akcizë”, parashikuara neni 172 i Kodit Penal.

26.3 Referuar akteve të administruara dhe vendimit të çështjes, objekt vlerësimi, në lidhje me kryerjen e kësaj veprë penale, është pranuar e provuar se në datën \*\*\*.9.2015 i gjykuari, punonjës i Autoriteti Portual Durrës, gjatë ushtrimit të detyrës si kontrollor automjetesh, “*check in*”, është ndaluar në kushtet e flagrancës nga autoritetet e policisë kufitare, pasi në automjetin e tij ndodheshin steka cigaresh të markave të ndryshme, për të cilat nuk ishte paguar detyrimi doganor.

26.4 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2015, ka vendosur: [...]Deklarimin fajtor të pandehurit \*\*\*.\*\*\* me 6 muaj burgim ... uljen e dënimit (neni 406 K. Penal) dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim (neni 63/1 K. Penal), duke urdhëruar që i pandehuri të punojë në funksion të publikut për një periudhë prej 40 orë punë [...].

26.5 Në Raportin e datës \*\*\*.12.2019, KLGJ-ja, në cilësinë e organit ndihmës të institucioneve të rivlerësimit, ka analizuar në mënyrë të detajuar këtë vendim dhe, në përfundim, parashtron se: [...]Masa e dënimit me 4 muaj burgim është në kufijtë minimal që parashikon dispozita neni 172 i Kodit Penal ose rreth 5% të dënimit maksimal...Nuk ka asnjë rrethanë lehtësuese sipas nenit 48 të K. Penal, ka 1 rrethanë rënduese në nenin 50, germa “b”, të K. Penal...Gjykata gjithashtu ka keqinterpretuar nenin 63/1 të K. Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit duke zëvendësuar atë me punë në interes publik pasi dispozita kërkon rrezikshmëri të paktë të personit dhe rrethana në favor të tij...masa e dënimit ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i Kodit Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës[...].

---

*profesionale të realizuara për subjektin e rivlerësimit \*\*\*.\*\*\*, sipas arsyetimit të mësipërm. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit konsideron me rëndësi që, për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016[...].*

<sup>40</sup> “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarës Anita Mici”, për periudhën 8 tetor 2013- 8 tetor 2016, përgatitur nga KLGJ, me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2019.

26.6 Komisioni, pasi ka administruar ai vetë vendimin objekt vlerësimi, si dhe ka marrë në konsideratë opinionin e organit ndihmës KLGJ, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegimet e saj.

26.7 Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Nga vetë përmbajtja e këtij vendimi, rezulton se unë, si subjekt rivlerësimi, me cilësinë e gjyqtarit të çështjes, në rastin konkret kam caktuar të njëjtin lloj mase dhe alternative të vuajtjes së dënimit të kërkuar nga përfaqësuesi i akuzës...ka zbatuar drejt kërkesat e nenit 63 të Kodit Penal, pasi nga tërësia e rrethanave objektive të çështjes dhe dënimit të caktuar për subjektin të pandehur, plotësohen të gjitha kërkesat e ligjit në nenin 63 të Kodit Penal, arsyetuar edhe në vendimin gjyqësor... Në këtë rast, i pandehuri ka paraqitur rrezikshmëri mjaft të ulët shoqërore dhe ka qenë i padënuar më parë, dhe masa e kontrabandës me mallra akcize, siç rezulton dhe nga pjesa e vendimit, që shprehet në lidhje me provën materiale, ka qenë tejet e ulët. Bëhet fjalë vetëm për 20 steka cigare, të cilat gjykata i ka konfiskuar dhe kaluar në favor të shtetit, ku kjo vlerë, jo vetëm tejkalon disa herë masën e detyrimit doganor të shmangur, por është vlerësuar nga ana e saj dhe si një ndëshkim me karakter financiar për të pandehurin, që i bashkohet dhe dënimit penal të dhënë. Pra, dënimi penal i caktuar në këtë rast është shoqëruar edhe me dënim plotësues, apo masë ndëshkuese financiare, që bashkëzojnë në një përcaktim mjaft të drejtë të dënimit në përputhje me kriteret e nenit 47 të Kodit Penal dhe që arrin plotësisht qëllimin e posaçëm të dënimit penal në drejtim të autorit të veprës penale[...].*

26.8 Komisioni, pasi ka administruar dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar se: [...] *nisur edhe nga fakti se vendimet e dhëna kanë mbetur në fuqi dhe se për to nuk janë konkluduar zvarritje të qëllimshme të procesit, çka do të pasqyronin anën procedurale të procesit gjyqësor apo probleme të tjera të natyrës procedurale, në tërësi nën argumentet e lartpërmendura, krijon bindjen se pretendimet e subjektit faktohen dhe, në këtë këndvështrim, nuk konstatohen problematika që të ndikojnë në vlerësimin profesional të saj [...].*

26.9 Referuar rolit dhe kompetencës të institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, referuar kriterëve vlerësues të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik vlerëson se duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuar nga KLGJ-ja, për mungesë të arsytimit ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me caktimin e masës dhe llojit të dënimit në vendimin objekt vlerësimi.

**27. Vendim penal nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në të cilën subjekti ka pasur funksionin e gjyqtarit të vetëm (f. 67-71 e vendimit të Komisionit).** Vlerësimi profesional i subjektit për këtë dosje gjyqësore është pjesë e raportit të inspektimit të aftësive profesionale, nga organi përgjegjës i kohës (v. 2016), Ministria e Drejtësisë.

27.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij vendimi, nëpërmjet shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018<sup>41</sup>, e cila i ka përcjellë Komisionit “Raportin e inspektimit të kryer...”<sup>42</sup>, bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2016.

27.2 Me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.2015, objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesën me objekt: “zëvendësim mase sigurimi personal”, paraqitur nga shtetasi

<sup>41</sup> Referohuni akteve përkatëse në fashikullin e Komisionit.

<sup>42</sup> Raport mbi inspektimin e kryer në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, Tiranë.

\*\*\*.\*\*\*, i arrestuar nga organi procedues për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 79/dh, 22 dhe 278/5 i Kodit Penal.

27.2.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka administruar vendimin gjyqësor të kësaj çështje, nga ku rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.3.2015, ka vendosur: [...] *të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të dyshuarit \*\*\*.\*\*\*, për kryerjen e veprave penale parashikuar në nenet 79/dh e 22 dhe 278/5 të K. Penal. Caktimin si masë sigurimi personal ndaj të dyshuarit \*\*\*.\*\*\* atë të: “arrestit në burg” [...].*

27.2.2 Shtetasi në fjalë, në datën \*\*\*.4.2015, ka paraqitur, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën me objekt: “zëvendësimin e masës së sigurimit personal” të “arrestit me burg”, dhënë me vendimin nr.\*\*\*/2015, duke caktuar një masë më të lehtë sigurimi personal.

27.2.3 Me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.05.2015, objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit, përfundimisht, ka vendosur: [...] *Pranimin e kërkesës. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal: “arrest në burg”, caktuar ndaj të dyshuarit \*\*\*.\*\*\*, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës në atë të: “Detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K. Pr. Penale [...].*

27.2.4 Kundër këtij vendimi është ushtruar e drejta e ankimit nga organi i Prokurorisë, me datë \*\*\*.5.2015. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.6.2015, ka vendosur [...] *Ndryshimin e vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, si më poshtë: Rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me një masë më të butë [...].*

27.2.5 Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *se nuk kanë ndryshuar dhe nuk janë kushtet ligjore për të pranuar kërkesën e të arrestuarit \*\*\*.\*\*\*, nuk jemi para kushteve të nenit 260/2 të K. Pr. Penale... Në rastin konkret, nevojat e sigurisë nuk janë zbutur, jemi në të njëjtat kushte si në nisjen fillestare, për të njëjtat ngjarje, që janë duke u kryer veprime hetimore në lidhje me autorët e saj...nuk ka ndryshim të akuzës, në një akuzë më të lehtë apo nuk paraqiten shkaqe shëndetësore apo familjare që të justifikojnë uljen e nevojave të sigurimit [...].*

27.2.6 Në Raportin e inspektimit të lartpërmendur, evidentohet fakti se: [...] *mbas vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, nga Policia Gjyqësore është kryer kontroll në banesën e të dyshuarit \*\*\*.\*\*\*, me qëllim vënien në ekzekutim të masës së sigurimit “arrest në burg”, por ai nuk është gjendur. Pra, i dyshuari është larguar duke iu shmangur hetimit, veprim i cili nuk do të kishte ndodhur nëse ndaj tij nuk do të ishte zëvendësuar masa e sigurimit arrest në burg nga gjyqtarja [...].*

27.3 Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2016<sup>43</sup>, në informacionin e dhënë Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konkluduar: [...] *se për gjyqtarët e inspektuar për të cilët ka rezultuar se nuk janë zbatuar dispozitat procedurale lidhur me kriteret caktimit të masës së sigurimit apo zëvendësimit të saj, shkeljet nuk kanë qenë të asaj shkalle që të passjellin fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve, por ato duhen mbajtur në konsideratë në rast përsëritjeje [...].*

<sup>43</sup> Referohuni prg.viii në f. 68, të vendimit të Komisionit. Ky qëndrim është reflektuar dhe në shkresën e Ministrisë së Drejtësisë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2019.

27.4 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime duke u përqendruar në pretendimet e organit të akuzës në ankimin e ushtruar ndaj vendimit të zëvendësimit të masës së sigurimit, në raport edhe me vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit, i cili ka mbetur i paekzekutuar, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të gjykimit të themelit të kësaj çështjeje<sup>44</sup>.

27.5 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me qëndrimin e organit të akuzës dhe po ashtu edhe me procedurën e ndjekur prej saj në gjykimin e kësaj çështjeje, duke kundërshtuar çdo konstatim të raportit të inspektimit. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar informacion dhe akte edhe mbi statusin e çështjes së themelit.<sup>45</sup>

27.6 Komisioni, në analizë të shpjegime të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje gjyqësore, si dhe provave të administruara, ka arritur në përfundimin se: [...]subjekti ka argumentuar ligjërisht të gjithë procedurën e ndjekur lidhur me gjykimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurisë. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë është shqyrtuar çështja e themelit, madje rezulton se i pandehuri është shpallur i pafajshëm, në një logjikë të drejtë, të bazuar në prova dhe ligj, edhe zëvendësimi i masës së arrestit ndaj të pandehurit rezulton të jetë trajtuar nga subjekti në mënyrë korrekte, në kohë dhe procedurë, duke u bazuar në kërkesa procedurale ndaj organit të akuzës, grumbullim të provave dhe fakteve të reja në dobi të procesit deri në zëvendësimin e masës. Në këtë kontekst, trupi gjykues nuk konstaton problematika apo shkelje të kryera nga subjekti lidhur me këtë çështje<sup>46</sup>[...].

27.7 Referuar rolit dhe kompetencës të institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, referuar kriterëve vlerësues të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik vlerëson se duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuara nga organi inspektues i kohës, në drejtim të mungesës së analizës dhe argumentimit logjik të subjektit rivlerësues, në vendimin objekt vlerësimi.

**III. Vendim nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, ku subjekti është në cilësinë e gjyqtarit të vetëm (nr. 3, f.76 e vendimit të Komisionit).** Vlerësimi profesional i subjektit për këtë dosje gjyqësore është bërë referuar denoncimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, administruar në përputhje me nenin 53, të ligjit nr. 84/2016.

**28.** Nga aktet e dosjes së Komisionit, në zbatim të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit të rivlerësimit, është protokolluar denoncimi nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2017, i shtetasit \*\*\*.\*\*\*.

**29.** Denoncuesi, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka denoncuar fakte: [...] për një proces gjyqësor të zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit pas 10 viteve që kishte ezauruar në rrugë gjyqësore një çështje pronësore të tij dhe familjes së tij, përfunduar me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2001... Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të gjykimit të themelit marrë në vitin 2001....nuk është njoftuar sipas nenit 151 dhe 152 të K. Pr. Civile për gjykimin civil me objekt: “rivendosje në afat”, në vitin 2010, ku gjyqtare është subjekti i rivlerësimit [...].<sup>47</sup>

<sup>44</sup> Referohuni rezultateve të hetimit administrativ, në dosje të Komisionit, f. 43.

<sup>45</sup> Referojuni më gjerësisht, prapësimeve të subjektit në dosje të Komisionit si dhe akteve paraqitur në përgjigje të prapësimeve.

<sup>46</sup> Referojuni fq.71, të vendimit të Komisionit.

<sup>47</sup> Denoncuesi ka depozituar vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe disa raporte mjekësore, për të cilat pretendon se i takojnë personave të dhunuar të familjes së tij për

- 29.1.1 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2001, me paditës shtetasin \*\*\*,\*\*\* (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi \*\*\*,\*\*\*), të paditur Bashkia Durrës, shtetasit \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\* (në mungesë), me objekt plotësim vendimi, njohje bashkëpronar, njohje pronar, ndër të tjera, si pjesë të dispozitivit, ka vendosur të pranojë kërkesë padinë e shtetasit \*\*\*,\*\*\* duke e njohur bashkëpronar me të paditurit e tjerë mbi sipërfaqe të kthyer, me vendim të KKPP, pranë Bashkisë Durrës.
- 29.1.2 Ndërkohë, nga aktet rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me gjyqtare të vetme subjektin e rivlerësimit, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2010, mbi kërkesën e \*\*\*,\*\*\* me objekt “rivendosjen në afat të ankimit” ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasës dhe rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- 29.1.3 Pas marrjes së vendimit nr.\*\*\* datë \*\*\*.12.2010 nga subjekti i rivlerësimit kërkuesja ka ushtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
- 29.1.4 Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2013, ka lënë në fuqi vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2001, duke arsyetuar ndër të tjera se: [...] *nga aktet e dosjes gjyqësore të themelit nuk ekziston asnjë shkak për cenimin e vendimit të gjykatës, si për njoftimin e palëve për seancat gjyqësore, si dhe për zgjidhjen e themelit të çështjes. Gjykata në arsyetim ka sqaruar se e paditura në themelin e çështjes dhe njëkohësisht kërkuese në rivendosjen në afat të ankimit ndaj themelit, është njoftuar rregullisht dhe se fletëthirrjet janë të firmosura në prani të ftuesit, pavarësisht mosparaqitjes së saj [...].*
- 29.1.5 Bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke i kërkuar të japë shpjegime dhe të dorëzojë dokumentacion provues, në bazë të të cilit subjekti i rivlerësimit, ka vendosur dhe argumentuar vendimin, objekt vlerësimi.
- 29.1.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka parashtruar se [...] *Pavarësisht faktit se Gjykata e Apelit Durrës, pas shqyrtimit të çështjes nëpërmjet ankimit të rivendosur, ka lënë në fuqi vendimin e themelit të çështjes, duke mos konstatuar shkelje procedurale në njoftimet e gjykimit, seancave gjyqësore, kjo nuk e bën vendimin tim në kundërshtim me ligjin, pasi në vendimin e rivendosjes unë, si gjyqtar, nuk kam marrë në shqyrtim njoftimet e seancave gjyqësore, kjo nuk mund të jetë atribut i gjyqtarit të rivendosjes, por e Gjykatës së Apelit kur shqyrton çështjen në themel. Në këtë rast, nga ana ime është konstatuar pavlefshmëri e njoftimit të vendimit përfundimtar, shpallur në mungesë të palës kërkuese. Gjykata, që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat të ankimit, shqyrton vetëm ligjshmërinë e akteve që kanë njoftuar vendimin përfundimtar dhe jo akte që kanë synuar njoftimin e palëve gjatë gjykimit të çështjes në themel [...].*<sup>48</sup>

---

shkak të situatës së krijuar pas dhënies së vendimit nga subjekti i rivlerësimit. I ndjeri, babai i denoncuesit (me cilësinë e ish-pronarit) i është drejtuar me ankim edhe KLD-së në vitin 2011, duke i parashtruar të njëjtat pretendime për shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në gjykimin e çështjes civile me objekt: rivendosje në afat, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës.

<sup>48</sup> Referohuni përmbytjes së vendimit të Komisionit, f.77 pika 3.2, prg. 3. Subjekti ka depozituar aktin: “dëftesë komunikimi/njoftim vendimi”, për të qartësuar në pabazueshmërinë e pretendimeve të denoncuesit, si dhe vendimin gjyqësor nr. \*\*\*. Subjekti pretendon se në dëftesën njoftim - vendimi del qartë fakti se njoftimi i vendimit në mungesë për palën kërkuese ka pasur shkaqe haptazi pavlefshmërie. Ndërkohë, që i njëjti ftues gjyqësor e ka respektuar ligjin kur i ka njoftuar vendimin Bashkisë Durrës, edhe kjo palë në proces (shihni dy dëftesat e njoftimit të vendimit për palët në mungesë) dhe nuk e ka respektuar për kërkuesen \*\*\*,\*\*\*.

29.2 Komisioni, pasi ka administruar dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar se: [...] vërtet rivendosja në afat ka pasur lidhje të drejtpërdrejtë me pavlefshmërinë e aktit të njoftimit të vendimit të themelit të çështjes së vitit 2001, për shkak të mungesës së njëzës palë në shpalljen e vendimit, por, nga ana tjetër, padyshim, që pasoja e vendimmarrjes lidhet ngushtësisht me vijueshmërinë e ankimit për themelin e çështjes... Në këto kushte, ky ka qenë një element i rëndësishëm për t'u vlerësuar nga gjykata në rast të njoftimit të palës kundërshtare (sikurse e ka paraparë neni 152, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile) në procesin e rivendosjes, përveçse vlerësimit të afatit kohor tepër të gjatë të kërkimit të rivendosjes në afat nga gjykimi i themelit të çështjes, i cili duhet të bënte një lidhje logjike me pretendimin për mosmarrje dijani të një vendimi për 10 vite radhazi. Por, në vlerësim të përgjithshëm të rastit, nuk konstatohen problematika që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit [...] <sup>49</sup>.

29.3 Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe në këtë rast, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, për sa kohë as aktet e administruara dhe as parashtrimet e saj, nuk ndryshuan rezultatet e hetimit administrativ, fakt ky që argumentohet dhe në pjesën përkatëse të vendimit të Komisionit, të pasqyruar më lart.

29.4 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka përfunduar Komisioni se: [...] në vlerësim të përgjithshëm të rastit nuk konstatohen problematika që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit [...], vlerëson se ky denoncim i publikut, në referencë të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, përmban të dhënat e nevojshme për të vlerësuar mbi shkeljen, pasojat ligjore, rrethanat që krijojnë bindje se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat e identitetit të personit.

29.5 Cenimi i parimit të: “sigurisë juridike” për palët në këtë proces gjyqësor, në këtë rast ka ardhur si pasojë e mosthirrjes së palës tjetër në gjykimin me objekt: “rivendosjen në afat të ankimit”, veprim i detyrueshëm nga ligji, që duhej të ishte kryer nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm që shqyrtoi kërkesën.

29.6 Referuar rolit dhe kompetencës të institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në zbatim të kriterëve vlerësuese të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik çmon se vendimi gjyqësor, objekt vlerësimi, i marrë nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sikurse neni 152 i Kodit të Procedurës Civile, duhet të merret në konsideratë dhe të vlerësohet në drejtim të mungesës së analizës ligjore dhe argumentimit.

29.6.1 Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin orientues (JR) 21/2019, shprehet se: [...]konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku [...], kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, rezultatet e hetimit të këtij denoncimi të administruar sipas nenit 53, duhen konsideruar dhe në funksion të qëllimit kushtetues për rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

**30. Vendim penal nr. \*\*\*, datë \*\*\*,12.2016, i Gjykatës së Apelit Durrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues**

<sup>49</sup> Referojuni fq.77-78 të vendimit të Komisionit.



- 30.1 Komisioni ka marrë në verifikim këtë vendim penal si çështje e diskutuar dhe bërë publike për lirimin para kohe me kusht të të dënuarit, \*\*\*.\*\*\*.
- 30.2 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni rezultoi të ketë administruar dosjen gjyqësore të çështjes, nga ku është konstatuar se me vendim të Gjykatës së Lartë nr.\*\*\*, datë \*\*\*.7.2014, shtetasi në fjalë, përfundimisht, u gjet fajtor për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 78, paragrafi 1, neni 25 i Kodit Penal, neni 76, neni 22 i Kodit Penal dhe neni 278, paragrafi 2 i Kodit Penal dhe iu caktua një masë dënimi prej 25 vite burgim.
- 30.3 Gjatë fazës së ekzekutimit të këtij vendimi penal për dënimin me burgim, bazuar në legjislacionin përkatës, i dënuari ka paraqitur disa kërkesa për ulje dënimi dhe përfitime amnistie në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilat janë pranuar në vazhdimësi nga gjykata.
- 30.4 Në datën \*\*\*.6.2016, i dënuari ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën për lirim me kusht<sup>50</sup>, bazuar në nenin 64 të Kodit Penal. Me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.7.2016, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se i dënuari nuk përmbushte kushtet e caktuara nga neni 64 i Kodit Penal, pasi nuk kishte kryer  $\frac{3}{4}$  e dënimit të dhënë.
- 30.5 I dënuari ushtroi ankim kundër këtij vendimi pranë Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se ekzistonin kushtet e kërkuara nga K. Penal për pranimin e kërkesës së tij. Gjykata e Apelit Durrës (*ku subjekti i rivlerësimit është një nga anëtarët e trupit gjykues*), me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2016, vendosi lirimin para kohe me kusht, me arsyetimin se i dënuari (i burgosuri) tashmë ka vuajtur  $\frac{3}{4}$  e dënimit të tij, në referim të dinamikës së vuajtjes së dënimit të paraqitur para Gjykatës së Apelit më datë \*\*\*.12.2016.
- 30.6 Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.7.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në rekursin e paraqitur, parashtrohen si shkaqe ligjore, rrethana të lidhura me faktet si: (i) Gjykata e Apelit, (a) ka vlerësuar dhe pranuar  $\frac{3}{4}$  e dënimit të kryer në datën e gjykimit në Gjykatën e Apelit; (b) nuk ka marrë në vlerësim rrezikshmërinë e lartë që paraqiste i burgosuri, marrë në konsideratë veprat penale për të cilat është dënuar; (c) ka përfshirë si një rrethanë të re dhe provë uljen e dënimit me 45 ditë, në datën 1.12.2016, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Apelit është i datës 5.12.2016; (ii) më datë 31.10.2016, Gjykata ka shtyrë seancën për administrimin e tri vendimeve të themelit, për më shumë se 10 ditë përtej afatit të përcaktuar në nenin 427, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale, pasi konkretisht seanca u mbajt më datë 5.12.2016, duke bërë të mundur depozitimin e vendimit të datës 1.12.2016, për uljen e rishtë të dënimit me 45 ditë, për të dënuarin.
- 30.7 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me këtë vendim.
- 30.8 Në vijim të komunikimeve për këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar: [...] *në respekt të ligjit dhe kontrollit vertikal të zbatimit të tij, në gjykimin e çështjeve gjyqësore, vlerësoj se dhënia përgjigjeje e pretendimeve rekursuese të mësipërme është atribut ligjor vetëm i Gjykatës së Lartë, në të cilën kjo çështje ndodhet në pritje të gjykimit, siç dhe keni verifikuar... Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit ka përlllogaritur dhe pranuar  $\frac{3}{4}$  e vuajtjes së*

<sup>50</sup> Kërkesa fillestare ishte me objekt: “Pezullim të ekzekutimit të vendimit penal”, bazuar në nenin 59/a të Kodit Penal, kërkimi është ndryshuar gjatë gjykimin në shkallë të parë me objekt: “Lirim para kohe me kusht”, me bazë ligjore neni 64 i Kodit Penal dhe neni 477 i Kodit të Procedurës Penale.

dënimin ditën e gjykimit në Apel, vlerësoj se kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin, pasi, në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, i dënuari duhet të ketë plotësuar  $\frac{3}{4}$  e vuajtjes së dënimit për t'u liruar me kusht, në kohën kur atij i jepet kjo liri nga gjykata. Në kushtet që edhe Gjykata e Apelit është një gjykatë fakti dhe jo vetëm ligji, vlerësoj se nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që të gjendej i plotësuar kushti i vuajtjes së  $\frac{3}{4}$  të dënimit në kohën e gjykimit në apel... Në lidhje me pretendimin se nuk është marrë në konsideratë rrezikshmëria e lartë e të dënuarit, për shkak të veprave për të cilat është dënuar, vlerësoj se një element i tillë nuk është pjesë e kriterëve ligjore kumulative, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, pasi për çdo rast, rrezikshmëria e lartë e veprave penale që ka kryer një i dënuar është reflektuar në caktimin e dënimit ndaj tij, nëpërmjet vendimit të dënimit, ku në zbatim të kërkesave të nenit 47 të Kodit Penal, Gjykata që ka shqyrtuar çështjen e fajësisë dhe caktimit të dënimit në themel, ka reflektuar rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale në masën e dënimit të dhënë [...] (faqe 62 e vendimit).

30.9 Komisioni pasi ka administruar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, ka ardhur në përfundimin se: [...]nga leximi i literaturës bërë pikës 2, të nenit 462, të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes”, çmon se nëse vendimi i uljes së dënimit (i cili inicohet vetëm me kërkesë të të dënuarit) me 45 ditë, vlerësohet si përjashtim i të konsideruarit të të dënuarit me një dënim me 45 ditë më shumë se realiteti, atëherë në logjikë të drejtë ligjore kuptohet që, për sa kohë ky dënim ishte dhënë përpara se të vendosej lirimi para kohe me kusht, automatikisht nuk mund të dilte jashtë sferës së përlllogaritjes, pasi vendimmarrja do të bazohej mbi një situatë precedente dhe jo mbi atë të përditësuar. Dhe, gjithsesi, edhe një refuzim i mundshëm i kërkesës me të vetmin arsyetim që kishte dhënë edhe Gjykata e Shkallës së Parë – pra vetëm për mosplotësim të kushtit të vuajtjes së  $\frac{3}{4}$  të dënimit – ishte i destinuar për t'u riformuar, apo zëvendësuar/superuar nga një vendim i mëtejshëm, që do të përfshinte në përlllogaritje dhe nuk mund të injoronte efektet e një tjetër vendimmarrjeje më të hershme (jo të subjektit), të datës 1.12.2016, për uljen e dënimit të dhënë me 45 ditë, pas të cilit tejkalohej vuajtja e  $\frac{3}{4}$  të dënimit total. Pra, në thelb nuk rezulton të jetë deformuar situata faktike e rrethanave që plotësonin kriteret ligjore, por maksimalisht mund të diskutohet mbi momentin e vendimmarrjes... Trupi gjykues, në ndryshim nga pretendimi i bërë prezent nga subjekti në parashtrimet e saj, se prokurori e ka kuptuar gabim përcaktimin e nenit 427/5107 të Kodit të Procedurës Penale, në rastin kur Gjykata, në datën 31.10.2016, ka shtyrë seancën për administrim të tri vendimeve të themelit, për më shumë se 10 ditë sipas parashikimit të bërë në nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale dhe se, konkretisht, seanca është zhvilluar më 5.12.2016 (mbi një muaj nga parashikimi ligjor), veprim i cili ka mundësuar edhe depozitimin e vendimit të uljes së dënimit me 45 ditë, vëren se Gjykata në vendimmarrjen e saj, për të shtyrë seancën e kërkesës për lirim para kohe me kusht, me qëllim administrimin e vendimit të dënimit me burgim të përjetshëm, ka përdorur pikërisht këtë dispozitë. Nën këtë argument, trupi gjykues çmon se, trupi gjykues ku subjekti është anëtare e saj, ndërsa ka aplikuar nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale, nuk i është përmbajtur afatit të parashikuar nga kjo dispozitë për caktimin e seancës së radhës [...] (faqe 65, 66 e vendimit).

30.10 Komisioneri Publik, bazuar në të dhëna, të cilat aksesohen nga burime: “open sources”, të tilla si faqja zyrtare e internetit e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, me adresë: [www.gjykataelartë.gov.al](http://www.gjykataelartë.gov.al), konstaton se rekursi i prokurorit kundër vendimit nr.\*\*\*,

datë \*\*\*.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, është regjistruar pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me nr. \*\*\*, datë regjistrimi \*\*\*.12.2016, me status të shqyrtimi: “gjyq”.

30.11 Referuar përmbajtjes së neneve 433 dhe 434 të K.Pr.P., rezulton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. duke mos vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit, ka çmuar të kalojë çështjen për gjykim, duke vlerësuar në këtë mënyrë se rekursi i prokurorit në këtë rast është ushtruar për shkaqe që lejohen nga ligji.

30.12 Referuar përmbajtjes së nenit 434, paragrafi i dytë i K. Pr. P., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit të rekursit, do t’ i japë përgjigje të gjitha shkaqeve të ankimit të paraqitur nga prokurori.

30.13 Komisioneri Publik konstaton se vetë Komisioni ka kërkuar dhe administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shkaqet e rekursit të prokurorit të ushtruar ndaj vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, duke konkluduar edhe në mangësi në analizën ligjore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me pretendimet për zbatimin e nenit 427/5 të K. Pr. P.

30.14 Në të tilla rrethana fakti dhe ligji, në referencë të nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, sa kohë procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, në rastin konkret, do të përfundojë me marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni për transferimin organit kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, kërkon që kjo çështje të përfshihet në rrethin e vendimeve objekt vlerësimi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke u administruar eventualisht vendimi që do të marrë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi shkaqet e rekursit të prokurorit.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**31.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**32.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**33.** Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

**34.** Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34, 40-44, nenin 61, të pikave 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

**35.** Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**